



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM
Nr. 86, datë 04.03.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR
NR. 62 DATË 06.09.2018 “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS
KANALIZIME SARANDË SH.A.”

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (**VKM nr.958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 04.03.2021 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit për një ndryshim në vendimin e komisionit kombëtar rregullator Nr. 62 datë 06.09.2018 “Për licencimin e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Sarandë sh.a.”,

Vëren se:

1. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Sarandë (**UK Sarandë**) me shkresat nr. 69 prot. datë 05.11.2020 me lëndë “ Kërkesë për ndryshim të zonës së shërbimit UK Sarandë” ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**), për ndryshim të zonës së shërbimit, dokumentacionin e nevojshëm mbi shkaputjen e njësive administrative Aliko, Finiq, Dhiver, Mesopotam të Bashkisë Finiq që më parë shërbeshin nga UK Sarandë.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të ndryshimit të zonës së shërbimit të UK Sarandë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit.

3. KKRR ka licencuar shoqërinë UK Sarandë me vendimin nr. 62, datë 06.09.2018 “Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Sarandë sh.a.” me një afat 4 vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe për zonën e shërbimit si më poshtë:

Bashkia:	Sarandë
Bashkia:	Finiq (pjesërisht)
	Nj.Admin.Finiq, Fshati Vrion
	Nj.Admin.Aliko, Fshatrat Aliko, Çaush, Neohor, Tremul
	Nj.Admin.Dhiver, Fshati Navaricë
	Nj.Admin.Mesopotam, Fshatrat Livinë, Fitore, Krane, Ardhasovë

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Sarandë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

Në pikën 3 të vendimit të KKRR nr. 62, datë 06.09.2018 “Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Sarandë sh.a.”, bëhen këto ndryshime:

Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Sarandë sh.a është Bashkia Sarandë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani